



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

GUSHT 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë



ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

26 referime në Prokurori për 27 punonjës të Policisë së Shtetit, 2 punonjës të Gardës së Republikës dhe 5 shtetas, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

Në total 4 shtetas, nga të cilët; 2 punonjës policie, 1 punonjës i Gardës së Republikës dhe 1 shtetas të arrestuar në flagrancë.

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

Vendosur caktimi i masës ndaluese "Arrest në burg"

Në total 6 shtetas, nga të cilët; 3 punonjës të PMNZSH dhe 2 shtetas, ndërsa 1 shtetas tjetër është shpallur në kërkim

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Gusht janë kryer 4 inspektive; 1 i planifikuar dhe 3 të paplanifikuara që janë iniciuar nga ankesat e qytetarëve dhe të cilat i janë nënshtruar hetimit administrativ.

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar për muajin Gusht në total 2 praktika disiplinore dhe ka vendosur si vijon:

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur mosfillimin e hetimit për "Shkelje të rëndë" dhe rekomandimin për fillimin e hetimit disiplinor për "Shkelje të lehtë" dërguar DVP përkatëse dhe për dijëni DPPSH.
- Në 1 rast, për 6 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur për pezullim të hetimit disiplinor deri në përfundim të hetimit penal.

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE



Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun

488 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat;ilat:

190 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

138 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

160 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

139 ankesa

- Në 16 raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në 88 raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në 35 raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

151 ankesa